

VENDIM
Nr.429, datë 21.3.2006

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“BLU”
PERSONI FIZIK: Z. MENTOR GJUZI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me Vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve e me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit fizik, z.Mentor Gjuzi licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në komunën Golem.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj